



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 17, DATË 20.02.2020

MBI

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQATËS “RADIO MARIA”, LICENCUAR PËR  
RADION KOMUNITARE “RADIO MARIA”, PËR NDRYSHIMIN E KUSHTEVE  
TEKNIKE TË LICENCËS**

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve me:

Kërkues: Shoqata “Radio Maria”

Objekt: Shqyrtimi i kërkesës së shoqatës “Radio Maria”, licencuar për subjektin audio komunitare “Radio Maria”, për ndryshimin e kushteve teknike të licencës.

Baza Ligjore: Neni 19, pika 16 dhe neni 88 i ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

**VËREN:**

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) me vendimin nr. 60, datë 10.05.2017 ka miratuar dhënien e licencës së transmetimit audio të komunitetit, shoqatës “Radio Maria” për “Radio Maria”, për të mbuluar me sinjal audio qarqet Tiranë, Durrës, Lezhë dhe Shkodër. AMA me vendimet nr.129, datë 12.07.2017 dhe nr.152, datë 13.07.2018 ka vendosur ndryshimin e kushteve teknike të licencës së transmetimit.

AMA me vendimin nr. 85, datë 07.06.2019, ka vendosur reduktimin e zonës së shërbimit të subjektit nga “*Qarqet Tiranë, Durrës, Lezhë dhe Shkodër*”, në “*Qarqet Lezhë, Shkodër, Bashkitë Tiranë, Durrës, Kamëz, Vorë dhe Shijak*”, ndërsa me vendimin nr. 99, datë 11.07.2019, ka zgjeruar zonën e shërbimit në “*Bashkitë Elbasan, Cerrik, Belsh dhe Vlorë*”.



Referuar vendimmartjeve të cituara më sipër, zona e ofrimit të shërbimit e subjektit “Radio Maria” është “*Qarqet Lezhë, Shkodër, Bashkitë Tiranë, Durrës, Kamëz, Vorë, Shijak, Bashkitë Elbasan, Cërrik, Belsh dhe Bashkia Vlorë*”.

Pikat e transmetimit në përdorim nga subjekti “Radio Maria” janë si më poshtë:

<i>Pika e transmetimit</i>	<i>Frekuenca (MHz)</i>
Fushë Dajt	91.4
Tyrbe Lezhë	89.6
Rrëshen (Lurth)	89.3
Tarabosh	102.2
Midë	90
Velipojë	102.9
Petresh	98
Zvërnec	89.4

*Pikat e transmetimit të subjektit “Radio Maria”*

Shoqata “Radio Maria” me shkresën nr. 3 prot, datë 27.01.2020, administruar në AMA me nr. 352 prot., datë 28.01.2020 ka paraqitur kërkesë për ndryshimin e kushteve teknike të licencës, konkretisht ndryshimin e frekuencës nga 89.4 MHz në pikën e transmetimit Zvërnec, në frekuencën 92.6 MHz, duke argumentuar se: “...referuar performancës aktuale të transmetimit nga frekuenca 89.4 MHz, vihen re interferenca në disa pika të qytetit të Vlorës.”

AMA, pasi administroi shkresën e subjektit “Radio Maria”, me qëllim verifikimin e pretendimeve të tij, kreu matjen e shfrytëzimit të spektrit audio, në zonën e shërbimit *Bashkia Vlorë*, nëpërmjet sistemit të Qendëruar të Monitorimit të Frekuencave. Nga matjet rezultoi se, në këtë zonë shërbimi, në frekuencën që përdor subjekti (89.4 MHz) nga pika transmetuese Zvërnec, u matën sinjale të emetuara nga stacione të vendeve fqinje (italiane). Këto sinjale arrinin vlera të konsiderueshme (35 dBuV) dhe për pasojë sillnin dhe degradimin e sinjalit audio të emetuar nga stacioni i subjektit “Radio Maria” në pikën e transmetimit Zvërnec. Kryerja e matjeve u bë në bashkëpunim edhe me një përfaqësues teknik të subjektit “Radio Maria”. Përfaqësuesit të subjektit iu kërkua që për disa minuta të fikte stacionin transmetues me qëllim përcaktimin e nivelit të interferencës. Nga matjet e kryera rezultoi se vlera e sinjalit interferues kur stacioni ishte i fikur ishte 35 dBuV.

Neni 88 i ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar parashikon se: “1. AMA ndryshon kushtet e licencës së transmetimit audio dhe/ose audiovizive ... ç) kur interferencat e dëmshme nuk mund të shmangen në mënyrë tjetër;...”

AMA, duke konsideruar rezultatet e monitorimit, bëri studimin e planit të përdorimit të frekuencave radio FM 87.5 – 108 MHz, që shfrytëzohen për transmetime audio, në përfundim të të cilit rezultoi se në pikën e transmetimit Zvërnec ekzistojnë burime frekuencore të lira ndër të cilat edhe frekuenca 92.6 MHz, e propozuar nga subjekti “Radio Maria”.

Për sa më sipër, AMA arrin në përfundimin që kërkesa e subjektit, shoqata “Radio Maria”, është e drejtë dhe e mbështetur në ligj,



## PËR KËTO ARSYE,

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në bazë të nenit 19, pika 16 dhe nenit 88 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

### VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së shoqatës “Radio Maria” licencuar për radion komunitare “Radio Maria”, për ndryshimin e frekuencës 89.4 MHz, në pikën e transmetimit Zvërnec.
2. Subjektit “Radio Maria” i jepet në përdorim frekuenca 92.6 MHz në pikën e transmetimit ekzistuese në Zvërnec, me parametra teknikë të pandryshuar sipas tabelës më poshtë:

<i>Zona e shërbimit</i>	<i>Pika e transmetimit</i>	<i>Frekuenca MHz</i>	<i>Koordinatat X Y Z</i>	<i>Fuqia Nominale (W)</i>	<i>Përforcimi i antenës (dBi)</i>	<i>ERP (W)</i>	<i>Azimuth e (deg)</i>	<i>Lartësia e antenës (m)</i>	<i>Drejtimi i antenës</i>
Bashkia Vlorë	Zvërnec	92.6	19.2509 40.3033 68 4DMS	500	8	1528	140	30	D

3. Parametrat teknikë të pikave të transmetimit në Fushë Dajt, Tyrbe Lezhë, Rrëshen (Lurth), Tarabosh, Midë, Velipojë, Petresh mbeten të pandryshuara.
4. Subjektit i hiqet e drejta e përdorimit të frekuencës 89.4 MHz në pikën e transmetimit Zvërnec.
5. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar:**

**Gentian**

**SALA**

**Zëvendëskryetar:**

**Sami**

**NEZAJ**

**Anëtarë:**

**Agron**

**GJEKMARKAJ**

**Gledis**

**GJIPALI**

**Suela**

**MUSTA**